

**V E N D I M****I ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE OST SH.A.****Nr. 6 Date 14/08/2008****"PER TRANSFERIMIN E TITULLIT TE PRONESISE SE AKSIONEVE TE OPERATORIT TE SISTEMIT TE TRANSMETIMIT OST SH.A."**

Ne mbështetje të nenit 135 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" dhe të Urdhrit 586 datë 01.08.2008 të Ministrit të Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës "Për transferimin e titullit të pronësive të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a.", Asambleja e Aksionereve të sh.a. KESH-it në mbledhjen e saj të datës 14.08.2008,

V E N D O S I

1. Kryerjen e procedurave të nevojshme për transferimin e titullit të pronësive të aksioneve të shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a., nga sh.a. KESH-i tek Ministria e Ekonomisë Tregëtisë dhe Energjitikës.
2. Drejtoria e OST sh.a. të marrë masat për kryerjen e procedurave të nevojshme, si dhe depozitimin dhe regjistrimin e ndryshimeve në QKR brenda datës 15.08.2008.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PER AKSIONERIN E VETEM

Gjergj Bojaxhi

